



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

MINISTRI I SHTETIT PËR ÇËSHTJET
VENDORE

Nr. 357 Prot. Datë 29.01.2016

Nr. 680 Prot. Datë 01.02.2016

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Për përdorimin e Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara

Nisur nga vullneti i përbashkët institucional për të kontribuar në mbledhjen dhe raportimin e statistikave të harmonizuara për rastet e korrupsionit dhe krijimin e një historiku solid rezultatesh dhe zbatimin me efektivitet të masave nën Prioritetin 3 të Bashkimit Europian për Shqipërinë;

Në kuadër të:

- Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara si bazë të dhënash shtetërore krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.824, datë 7.10.2015;
- Monitorimit dhe analizës së të dhënave të rasteve të korrupsionit dhe përmirësimin e cilësisë së statistikave të institucioneve ligjzbatuese të masave kundër korrupsionit;

Duke synuar:

- Analizimin e pritjeve të korrupsionit dhe efektivitetit të masave kundër korrupsionit nëpërmjet shqyrtimit të një sistemi të unifikuar dhe kompjuterizuar të mbledhjes së të dhënave për rastet e korrupsionit; si dhe
- Rritjen e bashkëpunimi ndër-institucional;

Në zbatim të:

- Ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjit nr.10325/2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1012, datë 22.11.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore”
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 247, datë 20.03.2015 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020”;

- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 330, datë 28.5.2014 “Për miratimin e udhërrëfyesit për 5 prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian, 2013”;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 7.10.2015, “Për Krijimin, Administrimin dhe Përdorimin e Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara”;

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore (referuar në vijim si “*Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit*” ose “*Administratori i Sistemit*”) dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Statistikave të Harmonizuara, bien dakord sa më poshtë:

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj Marrëveshje është bashkëpunimi dhe koordinimi mes Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit dhe Prokurorisë së Përgjithshme për mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave elektronike mbi ndjekjen e veprave penale të korrupsionit sipas Formularit të Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshje.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është krijimi një historiku solid dhe gjurmimi i i rasteve të korrupsionit të funksionarëve shtetëror sipas listës së pozicioneve të Shtojcës 2 të kësaj Marrëveshje, si dhe gjenerimi i statistikave të harmonizuara.

Neni 3 Sistemi Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara

- 3.1 Sistemi Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara (në vijim “*Sistemi*”) është sistemi i grumbullimit të të dhënave elektronike nga institucionet shtetërore në lidhje me veprat penale të korrupsionit në formatin ëeb-based në adresën ëëë.act-albania.al.
- 3.2 Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë si përdorues të Sistemit do të hedhin, grumbullojnë dhe përditësojnë të dhëna mbi veprat penale të korrupsionit në përputhje me këtë Marrëveshje. Formularët dhe informacioni që do të hedhin në Sistem përdoruesit përcaktohen në Shtojcën 1 të kësaj Marrëveshje.
- 3.3 Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, është administratori i Sistemit për të gjithë përdoruesit në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.824, datë 07.10.2015.
- 3.4 Prokurori i Përgjithshëm do të ketë akses të plotë dhe të pakufizuar mbi të gjitha të dhënat e hedhura nga prokuroritë.
- 3.5 Prokurori i Përgjithshëm si dhe çdo prokurori, me kërkesë drejtuar Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, do të ketë akses në statistikave të harmonizuara të gjeneruara nga Sistemi dhe administruara nga Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit lidhur me të gjithë përdoruesit e tjerë të Sistemit.

Neni 4 Detyrime të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, në cilësinë e Koordinatorit të Sistemit, angazhohet dhe merr përsipër sa më poshtë:

- 4.1 Të vendosë në dispozicion të secilit nga Përdoruesit e treguar në Shtojcën 1 të kësaj Marrëveshje programin e Sistemit në formatin *ëeb-based*, i aksesueshëm nëpërmjet llogarive të veçanta të secilit përdorues dhe hostuar rregullisht nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- 4.2 Të zhvillojë trajnime dhe udhëzime përdoruesit mbi mënyrën dhe modalitetet përdorimit dhe mirëmbajtjes së Sistemit, si dhe të përgjigjet në çdo kohë në lidhje me kërkesa të veçanta të përdoruesve;
- 4.3 Të sigurojë që Sistemi të gjenerojë në çdo kohë raporte statistikore;
- 4.4 Të sigurojë hedhjen automatike në Sistem të të dhënave të pikës 1, 2 dhe 3 të Formularit të Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshje nga llogaria në Sistem e institucioneve të tjera shtetërore që kallëzojnë në prokurori përkatësisht.

Neni 5

Detyrime të Prokurorisë së Përgjithshme

- 5.1 Prokuroria e Përgjithshme angazhohet se brenda fushës së saj të kompetencës do të marrë të gjitha masat ligjore, strukturore dhe teknike për hedhjen e të dhënave në Sistem nga Prokuroria e Përgjithshme dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë sipas Formularit të Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshje.
- 5.2 Prokuroria e Përgjithshme do të monitorojë zbatimin dhe përdorimin e pandërprerë të Sistemit dhe do të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të garantuar:
 - a. saktësinë e të dhënave të hedhura në Sistem, përfshirë rastet *ex-ufficio*, sipas Formularit të Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshje;
 - b. hedhjen e të dhënave në pikën 4, 5 dhe 6 të Formularit të Shtojcës 1 pasi të kenë përfunduar hetimet dhe veprimet përkatëse hetimore, në çdo rast jo më vonë se 24 orë nga marrja e vendimit.
- 5.3 Prokuroria e Përgjithshme do të mirëmbajë në çdo kohë Sistemin sipas parametrave teknike/elektronike të udhëzuara nga Administratori i Sistemit dhe do të kërkojë asistencë të specializuar brenda një kohe të përshtatshme për të garantuar funksionimin optimal të Sistemit në çdo kohë.
- 5.4 Prokuroria e Përgjithshme merr përsipër të njoftojë Administratorin e Sistemit për çdo shqetësim, sugjerim apo kërkesë e cila kërkon ndërhyrje të menjëhershme në lidhje me përdorimin e Sistemit, si dhe të shkëmbejë me Administratorin e Sistemit informacionin e nevojshëm të përcjellë nga strukturat institucionale në varësi të saj.

Neni 6

Përdoruesit e Sistemit dhe koordinimi ndërmjet palëve

- 6.1 Prokuroria e Përgjithshme dhe të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë do të caktojnë një apo më shumë persona të cilët do jenë përdoruesit e Sistemit për institucionin e tyre, do të kenë akses të drejtpërdrejtë në llogarinë në Sistem të Prokurorisë së Përgjithshme apo prokurorive përkatësisht dhe do të hedhin të dhënat e kërkuara.
- 6.2 Administratori i Sistemit do të sigurojë fjalëpërdorim dhe fjalëkalim të mëvetëm për secilin nga personat e caktuar për përdorimin e Sistemit.
- 6.3 Secili nga përdoruesit e caktuar do të jetë pikë kontakti dhe do të koordinojnë punën me titullarin e institucionit dhe zyrën e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit
- 6.4 Prokuroria e Përgjithshme njofton me shkrim zyrën e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit personin/at përdorues të Sistemit për Prokurorinë e Përgjithshme dhe për të gjitha prokuroritë e rretheve gjyqësore brenda 20 (njëzetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje.

Neni 7

Konfidencialiteti i informacionit dhe i dokumentacionit

Palët do ta trajtojnë informacionin e marrë në zbatim të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 8 Dispozita të fundit

- 8.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zbatohet për një afat të pacaktuar.
- 8.2 Prokuroria e Përgjithshme dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë do të hedhin të dhëna sipas Formularit në shtojcën 1 të kësaj marrëveshjeje të krijuara nga data 1 janar 2016.
- 8.3 Prokuroria e Përgjithshme dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, brenda mundësive dhe disponueshmërisë së burimeve njerëzore, financiare dhe strukturore, si dhe vetëm pasi të kenë siguruar kapacitetet e duhura, do të hedhin të dhëna sipas Formularit në shtojcën 1 të kësaj marrëveshjeje me datë kallëzimi nga data 1 qershor 2014.
- 8.4 Palët do të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshjeje në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Komunikimi në çdo rast do të jetë në formë shkresore.
- 8.5 Marrëveshja përpilohet në 4 (katër) kopje dhe secila palë mban nga dy kopje të njëjta.

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

ADRIATIK LLAJLA



MINISTRI I SHTETIT PËR ÇËSHTJET



SHTOJCA 1



Koordinatori Kombëtar Antikorrupsion

Raportim/Njoftimi i Prokurorisë

1) Protokollimi.

Rast ex-office:

Numri dhe Data e Protokollit të Prokurorisë:

Institucioni Kallëzues:

Numri dhe Data e Protokollit të Kallëzimit:

2) Personat e Kallëzuar.

Numri i të Kallëzuarve:

Pozicioni 1:

Pozicioni 5:

Pozicioni 2:

Pozicioni 6:

Pozicioni 3:

Pozicioni 7:

Pozicioni 4:

Pozicioni 8:

3) Nenet e Korrupsionit sipas Njoftimit/Kallëzimit.

Neni 135

Neni 257

Neni 319/a

Neni 164/a

Neni 257/a

Neni 319/b

Neni 244

Neni 258

Neni 319/c

Neni 244/a

Neni 259

Neni 319/ç

Neni 245

Neni 259/a

Neni 319/d

Neni 245/1

Neni 260

Neni 319/dh

Neni 248

Neni 312

Neni 319/e

Neni 256

Neni 319

Nuk janë specifikuar nenet që e klasifikojnë si rast korrupsioni.

4) Stausi i Çështjes.

Mosfillim Procedimi

Numri dhe Data e Vendimit:

Fillim Procedimi

Numri dhe Data e Vendimit:

Numri i Personave:

Kodi i Pozicionit 1:

Kodi i Pozicionit 5:

Kodi i Pozicionit 2:

Kodi i Pozicionit 6:

Kodi i Pozicionit 3:

Kodi i Pozicionit 7:

Kodi i Pozicionit 4:

Kodi i Pozicionit 8:

Nuk është klasifikuar si rast korrupsioni

Numri dhe Data e Vendimit:

Pushim çështje

Numri dhe Data e Vendimit:

Rezullim hetimi

Numri dhe Data e Vendimit:

Çështja është dërguar në gjykatë

Gjykata ku dërgohet Çështja:

Numri dhe Data e Kërkesës për Gjykim:

5) Numri i Personave.

Numri i Personave të Dërguar në Gjykatë :

Pozicioni 1:

Pozicioni 5:

Pozicioni 2:

Pozicioni 6:

Pozicioni 3:

Pozicioni 7:

Pozicioni 4:

Pozicioni 8:

6) Nenet e Korrupsionit Sipas Akuzës së Prokurorisë.

Neni 135

Neni 257

Neni 319/a

Neni 164/a

Neni 257/a

Neni 319/b

Neni 244

Neni 258

Neni 319/c

Neni 244/a

Neni 259

Neni 319/ç

Neni 245

Neni 259/a

Neni 319/d

Neni 245/1

Neni 260

Neni 319/dh

Neni 248

Neni 312

Neni 319/e

Neni 256

Neni 319

SHTOJCA 2
Kategoritë e Zyrtarëve

| |
|--|
| Pozicioni |
| Presidenti |
| Kryeministri |
| Minister |
| Drejtori Kabinetit të Ministrave |
| Anëtarë i Kabinetit të Ministrave |
| Zëvendësminister |
| I emëruar nga Kuvendi |
| Anëtarë i Kabinetit të Kryeministrit |
| Anëtarë i Kabinetit të Zv. Kryeministrit |
| Titullarëve të institucioneve të pavarura |
| Drejtues i institucioneve të arsimit të lartë |
| I emëruari nga Këshilli i Ministrave |
| Titullar e institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave |
| Titullar e institucioneve në varësi të Kryeministrit |
| Gjyqtarë i Gjykatës të Lartë |
| Gjyqtarë e Gjykatës Kushtetuese |
| Gjyqtarë e Gjykatës se Krimeve te Renda |
| Gjyqtarë e Gjykatës se Shkalles se Pare |
| Gjyqtarë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë |
| Gjyqtarë të Gjykatës së Apelit |
| Prokuror i Prokurorisë së Përgjithshme |
| Prokuror i prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë |
| Prokuror i prokurorise se Apelit |
| Ambasador |
| Guvernator |

| |
|---|
| Zëvendësguvernator |
| Anëtarë të Këshillave Mbikëqyrëse |
| Pozicioni |
| Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Ministrave |
| Sekretar i Përgjithshëm në Presidencë |
| Sekretar i Përgjithshëm në Kuvend |
| Sekretar i Përgjithshëm në institucione të pavarura kushtetuese |
| Sekretar i Përgjithshëm në ministrinë e linjës |
| Sekretar i Përgjithshëm në institucionet e pavarura të krijuara me ligj |
| Drejtore departamenti |
| Drejtore i Drejtorisë së Përgjithshme në Kryeministri |
| Drejtore i Drejtorisë së Përgjithshme në ministrinë e linjës |
| Drejtore i Drejtorisë së Përgjithshme në institucionet e pavarura të krijuara me ligj |
| Pozicioni |
| Drejtore drejtorie në Kryeministri |
| Drejtore drejtorie në ministrinë e linjës |
| Drejtore drejtorie në institucione të pavarura të krijuara me ligj |
| Drejtore drejtorie në institucionet në varësi të Kryeministrit |
| Drejtore drejtorie në institucionet në varësi të ministrave të linjës |
| Drejtore drejtorie në institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave |
| Drejtore drejtorie në qark |
| Drejtore drejtorie në bashki |
| Pozicioni |
| Shef sektori i nivelit A ose B në administratë publike |
| Kancelarë gjyqësor |

| |
|------------------|
| Pozicioni |
| Specialist |

| |
|-----------------------|
| Sekretar i gjyqtari |
| Nëpunës Gjyqësor |
| Pozicioni |
| Cdo personel shërbimi |
| Tjetër |
| <i>(specifiko)</i> |